



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 449 Akti

Nr. 536 Vendimi
Tiranë, më 2.6.2022

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 31.5.2022, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Alma Bramo, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, përfaqësuar nga av. I. R., me nr. licence ***.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin dhe përfaqësuesen e saj ligjore në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Alma Bramo është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të saj si Prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Alma Bramo, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues, komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Alma Bramo, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 17.5.2022, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës se provës.

7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit, në seancën dëgjimore në datën 31.5.2022, ora 12:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën 31.5.2022, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësueses së saj ligjore, si dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

8.1 Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 2.6.2022.

II. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

9. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurisë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 . Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

10. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 dhe nr. 17, të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore, për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

11. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, për pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur me të, kanë rezultuar si vijon.

1. Apartament banimi me sipërfaqe 72.88 m², rruga “**”, Tiranë, në pronësi të personit të lidhur me subjektin (nëna)**

Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Në deklaratën *Vetting*¹, subjekti deklaroi se banon me nënën në apartamentin në pronësi të kësaj të fundit. Në deklaratën e pasurisë të personit të lidhur, nëna e subjektit ka deklaruar apartament banimi, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 72.88 m² dhe sipërfaqe të brendshme ndërtimi 63.52 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, në vlerën 1.900.000 lekë, pasuri e krijuar nga *shitja e apartamentit në qytetin e Rrogozhinës, kursime të jetës, nga puna e bashkëshortit të saj, si dhe kontributi i anëtarëve të familjes*.

1.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në datën 0.11.2015 (datë deklarimi 24.11.2015), subjekti i rivlerësimit, në seksionin të dhëna konfidenciale, deklaroi: “*Apartament banimi 1+1, me sipërfaqe banimi rreth 64 m², ***, hyrja ***, kati ***, në pronësi të kryefamiljarit (nënës)*”.

1.3 ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se në emër të shtetasës A. B. është e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 63.52 m².

FSHU-ja² konfirmon se me gjeneralitetet A. B., rezultoi abonenti me kontratë furnizimi energjie elektrike me nr. ***, me adresë Tiranë, lidhur në datën 8.3.2006.

1.4 Kontrata e shitblerjes për pasurinë e paluajtshme³ me nr. ***, datë 12.12.2008, me palë shitëse shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasen A. B., ka për objekt shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 9.10.2007, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. të brendshme ndërtimi 63.52 m², në vlerën 1.900.000 lekë. Kjo pagesë është kryer jashtë zyrës noteriale.

1.5 Në dokumentacionin e dosjes *Vetting*⁴ rezultoi edhe kontrata e sipërmarrjes, datë 30.8.2005, ku nëna e subjektit të rivlerësimit ka porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., një apartament me sipërfaqe 72.88 m², me vlerë 40.000 euro.

1.6 Në kontratën e datës 30.8.2005 është parashikuar pagesa e çmimit si vijon: (i) kësti i parë, prej 10.000 euro është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës në datën 30.8.2005, nga znj. A. B.; (ii) kësti i dytë, prej 10.000 euro do të paguhet në datën 28.12.2005; (iii) kësti i

¹Si pjesë të dosjes *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentet : vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 21.1.2009, në emër të shtetasës A. B., e cila ka të regjistruar pasurinë nr. ***, z. k. ***, e tipit apartament me sip. 63.52 m², nr. ***, kati i ***, në rr. “****”, Tiranë; kontratë shitblerje (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 12.12.2008, me palë shitëse shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe palë blerëse A. B., të apartamentit të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 9.10.2007, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në z. k. ***, të apartamentit me sip. 63.52 m², në vlerën 1.900.000 lekë; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 9.10.2007, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k; prokure e posaçme nr. ***, dt. 21.9.2007; certifikatë për vërtetimi pronësie për apartamentin në Rrogozhinë, me sip. 72 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, Kavajë, në emër të shtetasve Sh. B., A. B., A. B. dhe E. B.; kontratë shitblerje, datë 15.12.1993, me palë shitëse *** dhe palë blerëse Sh. B., A. B., A. B. dhe E. B., të apartamentit me sip. 55 m², në shumën 13.556 lekë; vendim nr. **8 akti, datë 7.10.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në lidhje me çeljen e trashëgimisë, në të cilën vendosen se pas vdekjes së Sh. B., trashëgimtarë ligjorë do jenë bashkëshortja dhe fëmijët me 1/5 pjesë; certifikatë për vërtetimi pronësie për apartamentin me sip. 72 m², në Rrogozhinë, Kavajë, në emër të shtetasve A. B., A. B., E. B., Alma Bramo dhe F. B.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.11.2005; kontratë shitblerje nr. ***, datë 4.4.2006, me palë shitëse A. B., A. B., E. B. (D.), Alma Bramo dhe F. B. dhe palë blerëse A. S., të pasurisë nr. ***, apartament me sip. 72 m², në Rrogozhinë, në vlerën 1.000.000 lekë; depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve nga shtetasja Sh. B. në vlerën 160.000 lekë etj.; depozitë kursimi në Bankën e Kursimeve nga shtetasja A. B. 40.000 lekë etj. Marrëveshje për depozitë me afat dt. 15.4.2004 në emër të Alma Bramo në Bankën e Kursimeve në vlerën 400.000 lekë; depozitë datë 5.7.2004 e shumës 400.000 lekë nga Alma Bramo në Bankën e Kursimeve; tërheqje në arkë në datën 29.5.2006, nga “Raiffeisen Bank”, nga Alma Bramo, të shumës 97.000 lekë.

²Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.1.2020.

³Depozituar nga subjekti me deklaratën *Vetting* (grupimi ***)

⁴Në dosjen *Vetting*, f. 321.

tretë, prej 18.000 euro do të paguhet në datën 25.3.2006; si dhe (iv) kësti i katërt prej 2.000 euro, do të paguhet me dorëzimin e çelësave të apartamentit porositësit.

1.7 Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 20.9.2016, pyetur në lidhje me vlerën e pasurisë dhe arsyen e mosdeklarimit të vlerës referuar kontratës së datës 30.8.2005, subjekti ka deklaruar: *“Konfirmoj deklarinimin dhe paraqes dokumentacionin për apartamentin e nënës”*.

1.8 Në lidhje me këto mospërputhje, pasi u pyet nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaron se: *“Pasi vura re mospërputhjen midis çmimit të apartamentit, sipas kontratës së porosisë dhe çmimit, sipas kontratës së shitblerjes së redaktuar nga Noteri Publik, pyeta nënën time, e cila më tha se nuk e kishte vënë re fare çmimin në kontratën e shitblerjes. Në DPV-në time të parë të fillim vitit 2016, unë kam dorëzuar çdo dokument që kishte nëna ime lidhur me apartamentin e saj dhomë e kuzhinë. Kam dorëzuar kontratën e porosisë së datës 30.8.2005 dhe çdo mandatpagesë, bërë nga nëna ime. Bashkë me to edhe kontratën e shitblerjes bërë gati 2 vjet më vonë. Në dijeninë time shumica e paguar për apartamentin është shumatorja e gjithë mandatpagesave, 40.000 euro dhe jo çmimi që shkruhet në kontratën e shitblerjes. Në këtë kontratë thuhet se çmimi është paguar jashtë zyrave të noterit, ndërsa janë paguar realisht 40,000 Euro. Ky është fakt dhe provohet nga mandatpagesat për paratë që ka derdhur nëna ime në arkën e shoqërisë. Nuk di përse ka ndodhur mospërputhja”*.

1.9 Në mbështetje të deklarimeve, ndër të tjera, subjekti ka bashkëlidhur: (i) kontratë sipërmarrje, datë 30.8.2005, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe znj. A. B.; (ii) mandatarkëtim nr. ***, datë 27.4.2006, vlera 2.096 euro; (iii) mandatarkëtim nr. ***, datë 5.4.2006, vlera 18.000 euro; (iv) mandatarkëtim nr. ***, datë 28.12.2005, vlera 10.000 euro; (v) mandatarkëtim nr. ***, datë 31.8.2005, vlera 10.000 euro; si dhe (vi) mandatarkëtim nr. ***, datë 27.4.2006, në shumën 23.000 lekë, ku znj. A. B. ka paguar për kontratë drita +ujë për apartamentin *** shk. **, objekti “****”.

1.10 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka trajtuar çështje me palë shoqërinë “****” sh.p.k. dhe/ose administratorin(ët)/ortakun (ët) e kësaj shoqërie.

Analizë e burimit të deklaruar të të ardhurave

1.11 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, analizoi burimet e të ardhurave të deklaruara për blerjen e këtij apartamenti banimi në çmimin 40.000 euro, sipas deklarinimit në deklaratën *Vetting*, ku nëna e subjektit ka deklaruar, si burim për blerjen e kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Rrogozhinës, kursime të jetës, të ardhura nga puna e bashkëshortit, si dhe kontributi i anëtarëve të familjes.

a) Të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Rrogozhinës

1.12 Në dokumentacionin pjesë të dosjes *Vetting*, ndër të tjera, subjekti ka bashkëlidhur edhe: (i) kontratë shitblerje, datë 15.12.1993, nëpërmjet së cilës prindërit dhe dy motrat e subjektit kanë blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesave Rrogozhinë, apartamentin 2+1, kundrejt çmimit prej 13.556 lekë; (ii) vendim nr. ***, datë 7.10.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së babait të subjektit, ku janë njohur si trashëgimtare ligjore të radhës së parë bashkëshortja dhe fëmijët me 1/5 pjesë secila; si dhe (iii) kontratë shitblerje, datë 4.4.2006.

1.13 Referuar kontratës së shitblerjes së datës 4.4.2006, shtetaset A. B., A. B., E. B., Alma Bramo dhe F. B. kanë shitur apartamentin me sip. totale 72 m², në z. k. ***, vol. ***, f. ***,

ndodhur në Rrogozhinë, në vlerën 1.000.000 lekë, shumë e likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

1.14 ZVRPP-ja Kavajë ka konfirmuar për ILDKPKI-në⁵ se në emër të shtetaseve A. B., Alma Bramo dhe F. B. ka qenë e regjistruar pasuria me nr. ***, vol. ***, z. k. ***, Rrogozhinë, pronë e fituar me kontratën e privatizimit të datës 15.12.1993, me bashkëpronar Sh., A., A. dhe E. B. dhe kjo pronë i është shitur shtetasit A. S., me kontratë të shitjes nr. ***, datë 4.4.2006. Në lidhje me të ardhurat e përfituara me kontratën e shitjes me nr. ***, datë 4.4.2006, nga znj. A. B. janë paguar edhe detyrimet përkatëse me mandatin nr. ***, datë 4.4.2006, të ZVRPP-së⁶, në shumën 5.000 lekë.

1.15 Në analizë të dokumentacionit ligjor të depozituar lidhur me këtë burim krijimi, Komisioni ka arritur në konkluzionin se ky burim është i dokumentuar.

b) Kursime nga puna e prindërve

1.16 Për të vërtetuar të ardhurat, kursimet e prindërve dhe të familjarëve, është depozituar bashkë me deklaratën *Vetting*, dokumentacioni në vijim: (i) vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga ISSh-ja, me anë të të cilit vërtetohet se për shtetasen A. B., të ardhurat, nga pensioni familjar për periudhën 1.6.2004 – 30.4.2005 dhe nga pensioni i pleqërisë për periudhën 1.5.2005 – 31.1.2017, janë në total në shumën 1.337.923 lekë; (ii) librezë pune në emër të A. B., plotësuar deri në datën 31.3.1999; (iii) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* me punëdhënësin DRSHTRR-në Durrës, për periudhën 1.1.1994 – 31.3.1994; (iv) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* me punëdhënësin Zyra e Punësimit Kavajë për periudhën 1.4.1994 – 31.3.1995 dhe 1.4.1998 – 31.3.1999; (v) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* me punëdhënësin Zyra e Punësimit Durrës për periudhën 1.4.1998 – 31.5.1998; (vi) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* me punëdhënësin Drejtoria e *** Durrës për periudhën 1.11.1996 – 31.3.1998.

1.17 Në dokumentacionin e depozituar në Komision⁷ në datën 18.3.2022, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur edhe shkresë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërorë, në të cilën janë pasqyruar të ardhurat nga pensioni i prindërve, të cilat për periudhën 1994 – 30.4.2006 rezultojnë në vlerën 787.477 lekë.

1.18 Në mbështetje të deklarimeve, subjekti ka vendosur në dispozicion edhe vërtetimin nga “Raiffeisen Bank” të datës 15.2.2022, që konfirmon: depozitë në emër të znj. Alma Bramo dhe znj. A. B. çelur në datën 5.7.2004, në vlerën 400.000 lekë, mbyllur nga znj. A. B., më 19.4.2005; depozitë në emër të znj. Alma Bramo, datë 15.4.2004, në vlerë 460,709 lekë, teprica në datën 15.7.2005 ka qenë në vlerën 483.233 lekë; depozitë në emër të znj. Alma Bramo, datë 23.1.2004, në vlerë 333.000.00 lekë, mbyllur më 15.4.2004; depozitë në emër të znj. A. B. çelur në datën 19.4.2005, në vlerën 628.000 lekë; një depozitë në emër të znj. A. B. çelur në datën 18.3.2003, në vlerën 70.000 lekë, mbyllur më 14.4.2005; depozitë 3-mujore në emër të z. Sh. B. çelur në datën 12.8.1997, në vlerën 12,000 lekë, gjendja më 30.2.2002 ka qenë në vlerën 349.418 lekë dhe më 30.5.2003 ka qenë 497.608 lekë, kjo depozitë është mbyllur më 19.4.2005 nga znj. A. B.; urdhërderdhje, datë 17.04.2003, të Bankës së Kursimeve, në vlerën 20.000 lekë, depozitë kursimi Sh. B.; (viii) urdhërtërheqje, datë 11.6.2003, në vlerën 160.000 lekë, nga depozitë kursimi, Sh. B.; urdhërtërheqje, datë 18.6.2003, në vlerën 40.000 lekë, nga depozitë kursimi, A. B.; urdhërtërheqje datë 18.6.2003, në vlerën 30.000 lekë, nga depozitë kursimi, Sh. B.; urdhërderdhje në vlerën 628.000 lekë, në depozitë kursimi 6-mujore nga znj. A. B., datë 19.04.2005; urdhërderdhje, datë 8.1.2003, në vlerën 50.000 lekë në depozitë kursimi

⁵Pjesë e dosjes së ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.9.2017.

⁶Bashkëlidhur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2020, nga ASHK-ja.

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2022, të KPK-së.

dyemërore Sh. dhe A. B., datë 19.4.2005; urdhërderdhje, datë 5.7.2004, në vlerën 400.000 lekë, në depozitë kursimi Alma dhe A. B.; urdhërderdhje, datë 4.7.2003, në vlerën 30.000 lekë, në depozitë kursimi Sh. B.; urdhërderdhje, datë 3.12.2002, në vlerën 50000 lekë, në depozitë kursimi Sh. B.; urdhërderdhje, datë 4.2.2003, në vlerën 30.000, në depozitë kursimi Sh. B.; urdhërderdhje, datë 17.4.2003, në vlerën 30.000 lekë, në depozitë kursimi A. B.; urdhërderdhje, datë 18.3.2003, në vlerën 70.000 lekë, depozitë A. B..

1.19 “Raiffeisen Bank” konfirmon se subjekti ka kryer tërheqje *cash* të shumës 956.686 lekë, konkretisht: (i) në datën 2.9.2005 ka tërhequr *cash* shumën 483.186 lekë; (ii) në datë 1.8.2005 ka tërhequr *cash* nga llogaria e pagës shumën 193.500 lekë; dhe (iii) në datën 21.4.2006 ka tërhequr *cash* nga llogaria e pagës shumën 280.000 lekë, për të cilat subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁸, ka deklaruar se *tri shumat e para kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë.*

1.20 Në referim të dokumentacionit, për periudhën janar 1994 – mars 1999, të ardhurat e dokumentuara të nënës së subjektit të rivlerësimit në total janë në vlerën 171.810 lekë, ndërsa të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, për periudhën shkurt 2000 – 30.4.2006, janë në vlerë 3.614.996 lekë.

1.21 Në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit⁹ në datë 18.3.2022, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur, ndër të tjera, edhe një shkresë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në të cilën janë pasqyruar të ardhurat nga pensioni të prindërve të subjektit, të cilat për periudhën 1994 – 30.4.2006, rezultojnë në vlerën 787.477 lekë.

1.22 Në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur për të provuar punësimin e babait të saj edhe deklaratën noteriale, datë 15.3.2022, nga shtetasit S. K., I. B. dhe A. D., të cilët deklarojnë se *në fillim të viteve 2000, babai i subjektit i pajtonte të punimet e tenderuara nga subjekti i vëllait të tij, kryesisht të karakterit të ndërtimit dhe të ardhurat na i paguante i ndjeri Sh. B....”.*

1.23 Lidhur me këto deklaratë noteriale, Komisioni pas analizimit të tyre ka vlerësuar se këto deklaratë provojnë kryerjen e punës /aktivitet të babait të subjektit, por nuk vërtetojnë shumën e të ardhurave të përfituara apo pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura, sipas detyrimeve ligjore të ligjit nr. 84/2016, prandaj edhe këto të ardhura nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.

1.24 Në përfundim të analizimit të dokumentacionit ligjor lidhur me të ardhurat e familjes, Komisioni ka vlerësuar në analizë të dokumentacionit ligjor se në total të ardhurat e dokumentuara për prindërit dhe subjektin e rivlerësimit, për periudhën 1994 – 30.4.2006, janë në vlerën 4.574.283 lekë, duke zbritur nga kjo shumë shpenzimet jetike për këtë periudhë në vlerën 2.603.061 lekë¹⁰, referuar viteve dhe pjesëtarëve të familjes.

Shuma 10.000 euro dhuruar nga xhaxhai i subjektit të rivlerësimit

1.25 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka përfshirë si burim edhe një shumë prej 10.000 euro të dhuruar nga xhaxhai, duke deklaruar, ndër të tjera, se *ishte xhaxhai që insistoi dhe i dha nënës 10.000 euro, në ato vite xhaxhai ka pasur biznes të shëndetshëm ndërtimi dhe kishte mundësi të na ndihmonte.*

1.26 Lidhur me këto të ardhura, Komisioni ka vlerësuar se për sa nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklarinimin para fillimit të detyrës, si burim krijimi për këtë pasuri të

⁸Përgjigje të pyetjes nr. 3.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2022, të KPK-së

¹⁰Për periudhën 1994 – 1999, sa 66% të të ardhurave familjare, ndërsa për periudhën 2000 – 30.4.2006, sipas të dhënave nga INSTAT, ILDKPKI-së.

paluajtshme dhe nuk provohet burimi i ligjshëm i tyre, nuk mund të merren në analizë si burim krijimi për këtë pasuri.

1.27 Mbështetur në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën financiare, për të evidentuar mundësinë financiare për blerjen e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 72.88 m², në rrugën “****”, Tiranë, në shumën 40.000 euro, nga nëna e subjektit, pa marrë në konsideratë në këtë analizë ndihmën e dhënë nga xhaxhai i subjektit, si dhe të ardhurat e padokumentuara nga puna e babait të subjektit.

Analiza financiare për periudhën 1.1.1994 – 30.04.2006

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e subjektit për periudhën shkurt 2000 – prill 2006	3.614.996
Të ardhurat nga paga dhe asistenca e nënës dokumentuar për periudhën	171.810
Të ardhura /përfitime nga pensioni nëna dhe babai për periudhën	787.477
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Rrogozhinë, më 4.4.2006	986.444
Dhurim nga xhaxhai i subjektit	0
Total të ardhura /të hyra financiare	5.560.727
Shpenzime për mobilim arredim për periudhën	378.000
Shpenzime për lidhje energjie elektrike dhe ujë, mandat, datë 27.4.2006	23.000
Shpenzime për konsum deri në datën 31.12.1999 (66% të ardhura familjare) ¹¹	285.021
Shpenzime për konsum sipas INSTAT, për periudhën 1.1.2000 – 30.4.2006	2.318.040
Total shpenzime/të dala financiare	3.004.061
Ndryshim mj. monetare cash gj. fillim-gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	39.895
Mjete monetare të disponueshme (1)	2.596.561
Pagesë për apartamentin me sip. 72.8 m ² , në Tiranë, në shumën 40.096 euro	4.939.827
Total pasuri	4.939.827
Detyrime financiare	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	4.939.827
Balanca e fondeve (1-2)	-2.343.266

1.28 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit se:

- i. ka mospërputhje lidhur me çmimin e deklaruar të apartamentit të blerë nga nëna e subjektit, pasi në deklaratën *Vetting* është deklaruar çmimi 1.900.000 lekë, ndërsa referuar kontratës së sipërmarrjes në vitin 2005 depozituar nga subjekti çmimi i blerjes rezulton 40.000 euro.
- ii. subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur të dokumentojë plotësisht burimet e të ardhurave të pretenduara për blerjen e apartamentit në pronësi të nënës në shumën 40.000 euro.

¹¹Vendimi nr. 18/2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.29 Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të njoftuara nga Komisioni, ka parashtruar se: *“Lidhur me apartamentin dhomë e kuzhinë, të vetmen pasuri të paluajtshme në emër të nënës sime, kam deklaruar çmimin e shitblerjes sipas kontratës së shitjes, kam dorëzuar edhe kontratën e sipërmarrjes dhe gjithë mandat pagesat e bëra nga nëna.*

Mospërputhjen e kam konstatuar vetë e para dhe nuk ka ardhur për fajin tim apo pakujdesinë time. Në fund, çmimi më i ulët në kontratën e shitblerjes është në favor të shitësit jo të blerësit. Bëj me dije se nuk është vetëm apartamenti i nënës sime me këtë, por në të njëjtin pallat për apartamente afërsisht me të njëjtën sipërfaqe çmimi është 1.900.000 lekë”.

1.30 Subjekti paraqiti në cilësinë e provës, dokumentacionin ligjor provues si vijon: (i) kontratë shitblerje, datë 5.12.2008, për apartamentin me sip. të përgjithshme 61.60 m² çmimi i shitjes është 1.700.000 lekë, si dhe kontratën e sipërmarrjes, datë 14.5.2005, për të njëjtin apartament nga ku rezulton çmimi 64.000 euro; (ii) kontratë shitblerje, datë 7.8.2008, për apartamentin me sip. të përgjithshme 72.88 m², çmimi i shitjes është 2.000.000 lekë, si dhe kontratën e sipërmarrjes, datë 23.8.2005, për të njëjtin apartament, nga ku rezulton çmimi 40.000 euro.

1.31 Më tej, subjekti sqaron se: *“Është fakt se në deklaratën Vetting nuk kisha deklaruar dhuratën e xhaxhait për nënën time për të blerë banesën. Kjo ka qenë pakujdesi e imja, nisur nga mendimi im se xhaxhai nuk ishte as person i lidhur, as person tjetër i lidhur me mua si subjekt rivlerësimi, sipas parashikimit të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nuk kisha detyrim për deklarim.*

Nuk kam pasur as qëllim mosdeklarimi, as ta fshihja. Për më tepër, flasim për një shtëpi të blerë nga nëna 10 vjet para deklarimit të detyrës. Megjithëse, xhaxhai im, nuk konsiderohet nga ligji as person i lidhur, as person tjetër i lidhur me mua, subjektin e rivlerësimit, unë solla dokumentacion provues ligjor për të ardhurat e xhaxhait nga biznesi i tij.

Lidhur me analizën tuaj financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë, veç sa sipër, do t'ju lutesha të mbani parasysh të ardhurat nga puna private e babait, jo vetëm ato të dokumentuara”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.32 Komisioni duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancën dëgjimore, arsyeton se:

a) Lidhur me saktësinë e deklaratimit

Trupi gjykues vlerëson se, bazuar në faktet e dala, nga hetimi administrativ dhe referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga subjekti, pas kalimit të barrës së provës, kontratave të ngjashme të depozituara prej saj për pasuri të paluajtshme apartamente në të njëjtin pallat, është konstatuar se kontratat ishin me të njëjtat problematika lidhur me çmimet e referuara në kontratat e porosisë dhe shitblerjes së këtyre pasurive.

Për sa u provua, kjo praktikë e çmimeve të ndryshme të dokumentacionit ligjor mes palës shitëse dhe asaj blerëse, jo vetëm për nënën e subjektit, por edhe për banorë të tjerë të këtij pallati, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë palë në nënshkrimin e këtyre akteve ligjore, për sa nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se kjo pasuri është porositur dhe është paguar

nga nëna e subjektit të rivlerësimit, e cila ka nënshkruar edhe gjithë dokumentacionin ligjor.

Si përfundim, nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur, nëna e subjektit, kanë paraqitur në mënyrë të pasaktë vlerën e blerjes së këtij apartamenti. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm se kjo pasaktësi në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 nuk ka pasur për qëllim fshehjen e shumën së blerjes.

Ky konkluzion bazohet jo vetëm në dokumentacionin justifikues, kontrata e porosisë e vitit 2005 dhe mandatpagesat e depozituara nga subjekti, por edhe nga vlerësimi i të gjithë deklaramit të subjektit në tërësi, duke mos krijuar dyshime për fshehjen e çmimit të blerjes.

b) Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

Pikat 1, 2 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pika 1, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, si dhe formulari i deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihen mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.

b/1 Lidhur me shumën 10.000 euro, dhuruar nga xhaxhai i subjektit të rivlerësimit, e cila sipas pretendimeve të subjektit ka shërbyer për pagimin e një pjese të çmimit të apartamentit, trupi gjykues vlerëson se ky burim krijimi është shtuar nga subjekti, pasi nuk ka qenë deklaruar për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, as në deklarimin *Vetting* apo në deklarimin për herë të parë. Duke u mbështetur në vendimmarrjen e Kolegjit¹², trupi gjykues e konsideron këtë deklaram mbi këtë burim si deklaram të kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, duke vlerësuar për sa më sipër të mos e marrë atë në konsideratë për krijimin e pasurisë së paluajtshme, objekt gjykimi.

b/2 Lidhur me të ardhurat e motrës nga shkrimet/botimet dhe aktivizimi në media, Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti në cilësinë e provës mbi të ardhurat e të motrës, arrin në përfundimin se ky dokumentacion provon tej çdo dyshimi mundësinë e motrës së subjektit për krijimin e të ardhurave, por nuk provon as shumën e përfutur dhe as pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

b/3 Lidhur me të ardhurat nga puna e babait të subjektit, Komisioni vlerëson se për t'u marrë në konsideratë në analizën financiare trupi gjykues nuk mund të bazohet vetëm te deklaratat noteriale të individëve, të cilët kanë qenë të punësuar nga babai i saj për kryerjen e punimeve të ndërtimit, për sa në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Lidhur me shpenzimet jetike të llogaritura për familjen, për periudhën 1994 – 1999, sa 66% të të ardhurave familjare, ndërsa për periudhën 2000 – 30.4.2006, sipas të dhënave nga INSTAT-i dhe ILDKPKI-ja, ato referuar kërkimit të subjektit nuk mund të ndryshojnë me vendbanimin.

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme financiare për të blerë këtë apartament.

¹²Nr. 34/2019, datë 2.12.2019; nr. 2/2020, datë 27.2.2020: [Kolegji arsyeton se, referuar jurisprudencës së tij, deklaratat noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijojnë bindjen se është konceptuar në favor të deklaramit të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaramitave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit ...].

Pavarësisht këtij përfundimi, Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për personin e lidhur, nënës së subjektit, në blerjen e këtij apartamenti nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, për arsyet si vijojnë:

- i) Në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme, krijimi dhe marrëdhënia financiare për pagimin e saj është provuar nga hetimi administrativ se subjekti nuk ka asnjë shfaqje të vullnetit të saj, duke u provuar se nuk ka asnjë nënshkrim të asnjë dokumenti ligjor për përfitimin e saj dhe asnjë pagim të kësteve për këtë pasuri.
- ii) Pasuria është regjistruar në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në emër të nënës së subjektit.
- iii) Vetëm te pjesa takuese e babait të subjektit mbi këtë pasuri prej ½ si pjesë e pasurisë bashkëshortore, është pasuria ku subjekti tërheq të drejta pasurore si trashëgimtare ligjore e radhës së parë për 1/5 pjesë, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore sipas nenit 74 të Kodit të Familjes.

1.33 Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat lidhur me pasaktësinë e deklaramit dhe pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të nënës së saj për përfitimin e kësaj pasurie nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

2. Depozitë në shumën 400.000 lekë në “Raiffeisen Bank”

2.1 Në deklaratën *Vetting*¹³ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100 %.

2.2 Nga aktet e dosjes së ILDKPKI-së¹⁴, në emër të subjektit rezulton: (i) një depozitë me afat 3-mujor, konfirmuar edhe nga kontrata depozitë me afat¹⁵, datë 28.9.2016, midis subjektit të rivlerësimit dhe “Raiffeisen Bank”, shuma e investuar në vlerën 400.000 lekë: (ii) shuma në vlerën 415.000 lekë është depozituar *cash* nga subjekti në datën 28.9.2016 në llogarinë e tij rrjedhëse, e cila investohet brenda ditës në depozitë me afat 3-mujor.

2.3 Në deklaramin e interesave vjetore periodike të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën e ndryshimit të pasurive dhe si burim të krijimit ka deklaruar, ndër të tjera, krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në datën 28.9.2016, në shumën 400.000 lekë, me burim gjendjet *cash* në shtëpi të deklaramura më parë.

2.4 Gjatë hetimit, në bazë të të dhënave nga “Raiffeisen Bank”¹⁶, rezultoi se kjo depozitë në lekë, në emër të subjektit të rivlerësimit, është krijuar më 28.9.2016, pasi nga subjekti është depozituar *cash* në të njëjtën ditë shuma prej 415.000 lekësh.

3. Gjendje *cash* në shumën 1.300.000 lekë

3.1 Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit rezulton e deklaruar kjo shumë *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Burim i krijimit: të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100 %.

3.2 Në deklaramin e interesave private para fillimit të detyrës, si dhe deklarimeve periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në gjendje *cash* në banesë: (i) në deklaramin

¹³Si pjesë të dosjes *Vetting*, subjekti ka bashkëlidhur: (i) kontratë depozite në shumën 400.000 lekë, datë 28.9.2016, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Alma Bramo; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 7.7.2017, nga “Raiffeisen Bank”, që konfirmon se në emër të znj. Alma Bramo ka depozitë me afat në vlerën 400.000 lekë, në datën 28.1.2017.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2017.

¹⁵Bashkëlidhur dokumentacionit të dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁶Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot, datë 15.1.2020.

e interesave private para fillimit të detyrës, në datën 2.11.2015, subjekti i rivlerësimit ¹⁷, ndër të tjera, ka deklaruar: “... gjendje cash nga kursimet e subjektit dhe të mamasë ndër vite në shumën 18.000 euro (në pjesë takuese 70%) ...”; (ii) në deklaratën e interesave periodike private për vitin 2015, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të pasurive dhe burim të krijimit; ndërsa në (iii) deklaratën e interesave periodike private për vitin 2016, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera: “...depozitë bankare pranë ‘Raiffeisen Bank’, krijuar më 28.9.2016, në shumën 400.000 lekë, të krijuar nga gjendja cash në shtëpi e deklaruar më parë, si dhe vlera cash në shtëpi 1.300.000 lekë ...”, ndërsa personi i lidhur (nëna) deklaroi shumën cash 5.000 euro me burim kursimet e jetës dhe të ardhura nga pensioni.

Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

3.3 Si burim për krijimin e shumës prej 18.000 euro gjendje cash në banesë në datën 2.11.2015, përdorur edhe për krijimin e depozitës pranë “Raiffeisen Bank”, në datën 28.9.2016, në shumën 400.000 lekë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet e saj dhe të nënës, ndër vite.

3.4 Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, datë 20.9.2016, subjekti i rivlerësimit, e pyetur në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes cash, ka deklaruar se: “Kjo shumë është gjendje cash e krijuar në vite nga kursimet e nënës dhe të miat nga pagat”.

3.5 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, përfshirë edhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.5.2006 – 2.11.2015, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe pjesëtarëve të familjes, nga burime të deklaruara të ardhurash për krijimin e kursimeve cash, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë, konkretisht:

Analiza paraprake e treguesve financiarë për harkun kohor 1.5.2006 - 2.11.2015	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhura të dokumentuara nga paga e subjektit për periudhën	8.000.288
Të ardhura nga interesat bankare	45.789
Të ardhura nëna nga pensioni për periudhën	1.040.663
Të ardhura motra nga puna e motrës për periudhën 2006 – 2013	3.478.147
Total të ardhura /të hyra financiare	12.564.887
Shpenzime int./kom. kredie në emër të subjektit në “Raiffeisen Bank”, disbursuar më 29.5.2006	9.790
Shpenzime për blerje automjeti motra në vitin 2013	340.592
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrime jashtë vendit për periudhën vetëm për subjektin	553.083
Shpenzime për mobilje dhe pajisje 2007 – 2.11.2015, deklaruar	160.000
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-ja për periudhën për 3 persona	4.334.193
Total shpenzime/të dala financiare	5.397.658
Ndryshim mjete monetare cash, deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	-2.471.040
Ndryshim mjete monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-236.513

¹⁷Në deklaratim të pasurive dhe burimit të krijimit.

Mjete monetare të disponueshme (1)	4.459.676
------------------------------------	-----------

3.6 Nga analiza financiare për periudhën 2006 – 2015 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë pasur mundësi kursimi të shumës së deklaruar gjendje *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë.

3.7 Komisioni, sa më sipër, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe për krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank”, në datën 28.9.2016, në shumën 400.000 lekë.

4. Depozitë në shumën 1.865 euro, në “Raiffeisen Bank”

4.1 Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit¹⁸ rezulton e deklaruar nga subjekti kjo depozitë. Burim i krijimit: të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100 %.

4.2 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, në datën 2.11.2015, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën deklarim të pasurive dhe burim të krijimit ndër të tjera ka deklaruar: “Gjendje në llogarinë në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 2.11.2015, shuma 1865 euro (100%) ...”.

4.3 Në deklaratën e interesave periodike private për vitet 2015 dhe 2016, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të kësaj llogarie depozitë në emër të saj.

4.4 Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”¹⁹ rezultoi se kjo depozitë në euro, në emër të subjektit të rivlerësimit, është krijuar në datën 8.8.2006. Për periudhën 2006 – 2016 kjo llogari ka pasur këto gjendje në fund të vitit:

Viti	Gjendje në datën 31/12
2006	5.000
2007	5.070
2008	6.320
2009	2.524
2010	2.444
2011	2.445
2012	2.445
2013	1.865
2014	1.865
2015	1.864
2016	1.857
<i>Vetting</i> datë 28.1.2017	1.857

Analizë e burimit të deklaruar për krijimin e kësaj depozite dhe mundësia financiare

¹⁸Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, ndër të tjera: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Alma Bramo me gjendje në vlerën 1.864 euro; (ii) nxjerrje llogarie datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Alma Bramo, me gjendje në vlerën 1.856 euro; (iii) shkresën nr. 209/2 prot., datë 7.7.2017, nga “Raiffeisen Bank”, e cila konfirmon se në emër të znj. Alma Bramo ka llogari në vlerën 1.856 euro, më 28.1.2017.

¹⁹Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 15.1.2020.

4.5 Si burim për krijimin e kësaj depozite në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “*të ardhurat nga paga*”, ndërsa në deklaram të interesave para fillimit të detyrës në vitin 2015 nuk ka deklaruar burim të të ardhurave për krijimin e saj.

4.6 Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja²⁰, në lidhje me llogarinë rrjedhëse të deklaruar para fillimit të detyrës në vlerën 1.865 euro, subjekti deklaroi se: “*Konfirmoj depozitën me burim krijimi nga paga në vite. Do të paraqes dokumentacionin përkatës*”.

4.7 Në bazë të dokumentacionit të “Raiffeisen Bank”, sa më sipër, kjo llogari është krijuar në vitin 2006 nga Komisioni në vlerësim të faktit se në prill të vitit 2006 janë likuiduar 2 këstet e fundit (në shumën 20.096 euro) të çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 72.88 m², në rrugën “****”, Tiranë, në pronësi të nënës²¹, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave të shumës prej 5.000 euro, të depozituara në depozitë me afat në “Raiffeisen Bank” në datën 8.8.2006.

4.8 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të derdhura në këtë depozitë në shumën 5.000 euro.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.9 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, sqaroi se: “*Sipas gjetjeve të Komisionit nuk kam arritur të dokumentoj burimin e ligjshëm të shumës 5.000 euro, në vitin 2006, gati 10 vjet para fillimit të detyrës si prokuror. Kjo shumë është kursyer pjesërisht nga të ardhurat nga punësimi im dhe pjesa tjetër nga të ardhurat që kishim në shtëpi.*

Burime të tjera nuk kemi pasur dhe askush nga anëtarët e familjes nuk kishte mundësi veç punës. Kontribuuesi kryesor ka qenë babai im. Ju e keni njohur punën e tij, por keni njohur edhe faktin se unë nuk kam arritur të provoj shumën e marra nga puna. Flasi për të ardhura informale të siguruara për shkak të punës së mundimshme të babait tim”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

4.10 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklarimeve në seancën dëgjimore arsyeton se:

4.11 Pikat 1, 2 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pika 1, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit detyron subjektin e rivlerësimit për deklaramin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të pasurisë dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra, shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, si dhe mjetet financiare për krijimin e saj.

4.12 Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, konstaton se edhe pas shpjegimeve të paraqitura, subjekti nuk ka arritur të vërtetojë mundësinë financiare me burime të ligjshme, për të cilat janë provuar se janë paguar detyrimet tatimore për krijimin e depozitës në vitin 2006.

4.13 Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga puna informale e të ndjerit, babait të saj, por nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion zyrtar që provon ushtrimin e aktivitetit në fushën e ndërtimit nga babai, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk ka provuar se është në

²⁰Procesverbal datë 20.9.2016, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

²¹Analizuar më poshtë në pasurinë apartament me sip. 72.8 m², në pronësi të nënës së subjektit.

kushtet e pamundësisë objektive për të siguruar informacion, sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

4.14 Në referim të jurisprudencës së Kolegjit, deklaratat noteriale, paraqitur nga subjekti për të provuar faktin se i ndjeri babai i saj ka zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit në periudhën e pretenduar, nuk mund të provojnë të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet.

4.15 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga babai i saj në mënyrë që të merreshin në konsideratë dhe të llogariteshin në analizën financiare.

4.16 Për rrjedhojë, për sa kohë nuk u vërtetua me dokumentacion ligjor, pretendimi i subjektit mbetet deklarativ dhe të ardhurat e pretenduara nuk mund të përfshihen në analizën financiare në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 21, të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, zotërim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016”.

4.17 Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve para periudhës së deklarimit në vlerën 1.850 euro, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Analiza e treguesve financiarë

4.18 Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, si dhe në deklaratat e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë nga data e fillimit të detyrës 2.11.2015 deri në datën 31.12.2016²².

4.19 Analiza e treguesve financiarë është kryer për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime, duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar nga Komisioni, në deklaratat e subjektit të rivlerësimit²³, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, konkretisht:

Analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën	2.11.2015 - 31.12.2015	Viti 2016
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga marrëdhëniet e punës dokumentuar për periudhën	20.674	997.702
Të ardhura/kontribut i nënës deklaruar	20.000	120.000
Total të ardhura/të hyra financiare	40.674	1.117.702
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrime jashtë vendit për periudhën	0	223.670
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	108.758	705.276
Total shpenzime/të dala financiare	108.758	928.946
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe	0	429.728
Ndryshim mjete monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	3.000	-402.021
Mjete monetare të disponueshme (1)	-65.084	216.463

²²Ndërsa për periudhën deri në fillim të detyrës është pasqyruar në analizën e kryer për pasurinë sa më sipër.

²³Nisur nga deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1 dhe sqarimet në pyetësorin nr. 2, në të cilin ka deklaruar se: “... për vitet 2005 - 2015, shpenzimet përfshijnë vetëm shpenzimet e mia të jetesës dhe kontribut minimal për bashkëjetesën, ndërsa për periudhën 2015-2016, kam paguar gjithë shpenzimet e jetesës për vete, nënën dhe motrën, kontribuuese ka qenë dhe nëna me afërsisht shumën prej 10.000 lekë/muaj të pensionit të pleqërisë ...”. Nga Komisioni u vlerësua që analiza e treguesve financiarë për këtë periudhë të kryhet për subjektin e rivlerësimit, duke i ngarkuar shpenzimet e jetesës për tre persona (përfshirë edhe kontributin mujor të deklaruar të nënës).

4.20 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë me burime të ardhurash kryerjen e shpenzimeve për harkun kohor 2.11.2015 - 31.12.2015.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.21 Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të njoftuara nga Komisioni, ndër të tjera, sqaroi se: *“Për sa i përket konstatimit tuaj se për dy muaj unë nuk mbuloja dot shpenzimet e jetesës, bëj me dije se këto dy muaj përkojnë me momentin e fillimit të detyrës si prokuror dhe jam paguar për këto dy muaj. Motra, F., nuk ka qenë në marrëdhënie pune, por ka nxjerrë të ardhura duke shkruar nëpër gazeta dhe është paguar me honorare²⁴. Pavarësisht nga shifra e mosmbulimit të shpenzimeve sipas jush, pasi të merrni në konsideratë vërtetimin do të rishikoni përfundimin e arritur prej jush”.*

4.22 Lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, subjekti paraqiti në cilësinë e provës dokumentacionin ligjor provues si vijon: (i) vërtetim page me nr. *** prot., datë 23.5.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i cili vërtetohet se znj. Alma Bramo është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me Dekret nr. 9300, datë 2.11.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe marrëdhëniet financiare në këtë prokurori i kanë filluar më 4.11.2015 e deri më sot. Sipas vërtetimit për harkun kohor 4.11.2015 - 31.12.2015, subjekti është paguar me këto të dhëna page si vijon: (i) harku kohor 4.11.2015 - 30.11.2015 me pagë *bruto* në vlerën 95.324 lekë dhe pagë *neto* 73.296 lekë; (ii) harku kohor 1.12.2015 - 31.12.2015 me pagë *bruto* në vlerën 113.901 lekë dhe pagë *neto* 88.847 lekë. Ndërsa në lidhje me të ardhura të motrës nga shkrimet/botimet dhe aktivizimi në media, subjekti ka depozituar disa publikime/botime në media që datojnë që nga viti 2005.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

4.23 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet në seancën dëgjimore arsyeton se:

4.24 Në analizë të dokumentacionit ligjor provues të mësipërm, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës në përgjigje të barrës së provës, Komisioni pasqyroi ndryshimin e të ardhurave për harkun kohor 2.11.2015 - 31.12.2015 me shumën 73.296 lekë, si të ardhura *neto* për muajin nëntor të vitit 2015, ndërsa për sa i përket shumës prej 88.847 lekësh si pagë për muajin dhjetor të vitit 2015, është transferuar në llogari të subjektit në vitin 2016.

4.25 Komisioni rishikoi analizën financiare duke përllogaritur të ardhurën nga paga e subjektit të rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe pas rillogaritjes, rezultoi për harkun kohor 2.11.2015 - 31.12.2015, në balancë pozitive në vlerën 8.212 lekë.

4.26 Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të dokumentojë me burime të ardhurash të ligjshme kryerjen e shpenzimeve për harkun kohor 2.11.2015 - 31.12.2015, sipas përcaktimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

❖ Pasuri në pronësi të personit të lidhur/motrës së subjektit të rivlerësimit

5. Automjet tip “Mercedes-Benz A 170 CDI Daimler Chrysler”

²⁴L. D. vendim.

5.1 Në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur (pjesë e deklaratës *Vetting*), motra e subjektit ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz A170 CDI Daimler Chrysler”, prodhimi i vitit 2000, me targa ***, blerë në mars të vitit 2013, në shumën 2.000 euro me pjesë takuese 100%²⁵. Gjithashtu, znj. F. B. (motra e subjektit) ka deklaruar, ndër të tjera, se kjo pasuri është krijuar nga të ardhurat e saj si specialiste në ***, që nga korriku i vitit 2006.

5.2 Referuar të dhënave nga DPSHTRR-ja²⁶ konfirmohet pronësia nga znj. F. B. e automjetit me targa ***. Gjithashtu, në bazë të këtyre të dhënave rezulton se automjeti tip “Mercedes-Benz A170 CDI Daimler Chrysler” është blerë me kontratë blerjeje nga motra e subjektit në shumën 2.000 euro, si dhe janë shlyer detyrimet doganore me deklaratën nr. ***, datë 25.3.2013, në shumën 60.192 lekë. Leja e qarkullimit rrugor, në emër të shtetases F. B., i përket datës 18.4.2013.

Lidhur me burimin e të ardhurave të motrës së subjektit për blerjen e automjetit

5.3 Në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur (pjesë e deklaratës *Vetting*), motra e subjektit ka deklaruar të ardhurat nga paga si burim për blerjen e këtij automjeti. Gjithashtu, në dosjen *Vetting* subjekti ka bashkëlidhur edhe vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017 nga Ministria e ***, me anë të të cilit vërtetohet se znj. F. B. ka qenë punonjëse pranë këtij institucioni për periudhën 10.7.2006 – 8.11.2013 dhe të ardhurat *neto* të përfituara nga paga rezultojnë në vlerën 3.426.626 lekë.

5.4 Sa më sipër, Komisioni, duke u mbështetur edhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, si dhe në pjesë të dosjes së ILDKPKI-së në lidhje me pasuri dhe/ose të ardhura të tjera të kësaj shtetaseje, arrin në përfundimin se motra e subjektit ka pasur burime të ligjshme të ardhurash për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz A170 CDI Daimler Chrysler” në shumën 2.000 euro, si dhe shlyerjen e detyrimeve doganore në shumën 60.192 lekë, në datën 25.3.2013.

❖ Gjetje të tjera gjatë hetimit administrativ

6. Subjekti, në pyetësorin nr. 2, u pyet në lidhje me transferimin e disa shumave dhe destinacionin e tyre pasi janë tërhequr, i cili deklaroi se: *“Paratë janë transferuar në llogarinë time nga motra E. D. (B.) dhe bashkëshorti i saj, çka vërtetohet nga nxjerrja e llogarisë bankare. Motra dhe bashkëshorti kishin blerë një banesë në qytetin e Tiranës për të cilën nevojiteshin punime. Për t’u marrë me këtë punë, me anë të prokurës së posaçme ishte autorizuar motra ime, F. B.. Motra nuk kishte llogari bankare andaj ishte minimale t’i bëja një shërbim motrës që është me banim në Itali. Nuk kisha dhënë ndonjëherë hua te motra, ka qenë gjithmonë e kundërta. Paratë e tërhequra ia kam dhënë motrës së vogël, e cila është marrë me pagesat dhe punët e apartamentit. Nuk di përse është shkruar ‘kthim huaje’, pasi nuk është shkruar prej meje”*.

6.1 Në mbështetje të shpjegimeve të sipërcituara, subjekti ka vendosur në dispozicion: (i) kopje të kontratës së sipërmarrje me nr. ***, datë 29.9.2008, me porositës N. dhe E. D. dhe palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe shoqëria “****” sh.p.k. për dorëzimin porositësit të një apartamenti me nr. *** (1+1), sip. 55.1 m² të një apartamenti me nr. *** (1+1), sip. 62.1 m² dhe një vendparkim në katin e nëntokës në shumën totale 137.200 euro; (ii) prokurën e posaçme nr. *** për motrën F. B..

6.2 Trupi gjykues, pas vlerësimit të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, vlerëson se për sa i përket këtyre transaksioneve

²⁵Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (4/8) janë depozituar, ndër të tjera, edhe: (i) dosje e automjetit me targa ***. Deklaratë doganore datë 25.3.2013; (ii) kontratë blerjeje me palë shitëse C. C. dhe palë blerëse F. B. tip “Daimler Chrysler A 170 CDI”, në vlerën 2.000 euro (gjermanisht dhe shqip); (iii) certifikatë e pronësisë së automjetit datë 18.4.2013, me targa ***, në emër të znj. F. B..

²⁶Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.1.2020.

subjekti ka arritur të provojë dhe të shpjegojë qëllimin e këtyre transaksioneve bankare mes familjarëve.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj.

Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve para periudhës së deklarimit në vlerën 1.850 euro nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit dhe nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit.

Sipas vlerësimit të trupit gjykues, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, përgjegjësia për pasaktësinë e çmimit të pasurisë dhe për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në emër të nënës së saj, janë rrethana që në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ndryshojnë përfundimin e arritur se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo ka arritur një nivel të besueshëm të kriterit vlerësimit të pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin e deklasifikuar plotësisht²⁷, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar. Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Në raport citohet se subjekti i rivlerësimit, në germën “g”, të pjesës 5, “të dhëna për sigurinë”, në deklaratën për kontrollin e figurës, ka deklaruar se: *“I është refuzuar viza në 2007-ën nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Në pasaportë është shënuar germa ‘B’. Në vitin 2009 më është dhënë vizë”*. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Për sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Alma Bramo.

Konkluzion për kontrollin e figurës

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për

²⁷Vendim nr. ***, datë 7.7.2020, i KDZH-së.

kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues i tij, mbi bazën e kritereve të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit.

Raporti për analizën e aftësive profesionale, i kryer nga Këshilli i Lartë të Prokurorisë, është bazuar në: formularin e vetëvlerësimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë; sektorin e protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe arkivin e Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

C/1. Tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Në dokumentin ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të pandehur A. Gj. dhe kallëzues Sh. Gj., akuzuar për kryerje të veprave penale të parashikuara nga nenet 130/a-2 dhe 280 të Kodit Penal, nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika.

Në dokumentin ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me kallëzuese V. V. dhe të pandehur L. S., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a/1 i Kodit Penal, “përndjekja”, nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika.

Në dokumentin ligjor “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të pandehur A. Sh. dhe kallëzues inspektorët e Inspektoratit Vendor të Mbrotjtjes së Territorit, Bashkia ***, për kryerjen e veprës penale parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, “... ndërtim i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet deri në 1 vit burgim. Po kjo vepër e kryer në tokën publike ose tokë shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet ...”, nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe pas analizimit të dokumentacionit nga Komisioni, nuk janë konstatuar problematika.

C/2. Pesë dosjet e përzgjedhura me short

Dosja nr. 1 – vendim për mosfillimin e kallëzimit penal nr. ***, datë 17.5.2016, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të dëmtuar R. D. dhe të pandehur B. S.. Pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

Dosja nr. 2 – vendim pushimi për procedimin penal nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat në datën 23.5.2016, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, me të pandehur K. L. dhe të

dëmtuar R. L.. Pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni është konstatuar se:

- Në lidhje me bazën ligjore, ku mbështet vendimi i pushimit të hetimeve të procedimit penal, vërehet se prokurorja duhet t'i ishte referuar gurmës "b" dhe jo gurmës "a" të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se: *"Duke qenë se vendimmarrja ime daton në vitin 2016, mendoj se është një lapsus i kryer nga ana ime në shkrimin e gurmës 'a' në vend të gurmës 'b' të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale"*.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti me shkrim pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, në shpjegimet e saj, ka pranuar se nuk ka kryer saktësisht specifikimin e bazës ligjore, por arsyetimi i vendimit në thelb referon gurmën "a", të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale. Trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi nuk e penalizon subjektin, pasi shkak për të cilin ka pushuar procedimin ka qenë i saktë.

Dosja nr. 3 – kërkesë për gjykimin e çështjes penale, datë 9.6.2016, për procedimin penal nr. 66/2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me datë regjistrimi 13.4.2016, për veprën penale të "vetëgjyqësisë", parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

Dosja nr. 4 – kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë regjistrimi 14.11.2018, regjistruar për veprat penale "kanosje për deklaram a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë", parashikuar nga neni 312/a i Kodit Penal, me kallëzuese E. B. dhe të pandehur M. D.. Pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

Dosja nr. 5 – kërkesë për gjykimin e çështjes penale të procedimit penal nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë regjistrimi 4.4.2018, regjistruar për veprën penale "dhunë në familje", parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, me kallëzuese Sh. Sh. dhe të pandehur bashkëshorti L. Sh.. Pas analizimit të dokumentacionit në fashikullin penal, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika.

ANALIZA E GJETJEVE

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

Në aspektin profesional rezulton se ka shfaqur aftësi të mira në interpretimin e ligjit dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta. Gjithashtu, ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit profesional.

Konstatohet se prokurorja Alma Bramo është përballur me një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar efektivitet në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës dhe shumëllojshmërisë së veprimeve hetimore.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave, që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Alma Bramo, në ushtrim të kompetencave ligjore, ka aftësi për të administruar dosjet.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Alma Bramo dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Alma Bramo. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesmarrësit në proces.

Prokurorja Alma Bramo ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, si për ngritjen e nivelit profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit, duke u vlerësuar me certifikatat përkatëse.

Konkluzion për vlerësimin profesional

Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit; dhe (ii) gjetjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIMET

Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka analizuar 15 denoncimet e ardhura në Komision për subjektin e rivlerësimit. Në vijim të analizimit të materialeve lidhur me disa denoncime janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi, si vijon:

Denoncim i shtetasit A. B. Z.²⁸, regjistruar me nr. *** prot., datë 9.7.2018, i cili pretendon se në lidhje me kallëzimin e regjistruar me nr. *** në datën 1.12.2017, me nr. *** prot., pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj disa përmbaruesve shtetëror për veprën penale “shpërdorim detyre”, subjekti i rivlerësimit: (i) nuk i përmbahet aspak kallëzimit të paraqitur; (ii) nuk ka bërë asnjë hetim ndaj përmbaruesve shtetërorë: si dhe (iii) vendimi i subjektit për mosfillimin si procedim penal të kallëzimit nr. *** është kontradiktor për çfarë deklaroi. Denoncuesi i ka bashkëlidhur ankimit: (i) kopje të pjeshme të kallëzimit, datë 30.11.2017; dhe (ii) kopje të vendimit të mosfillimit, datë 14.12.2017. Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar me denoncimin nuk rezulton që ankuesi të këtë paraqitur ankim ndaj vendimit për “mosfillimin si procedim penal të kallëzimit nr. ***”.

Komisioni, pasi administroi aktet bashkëlidhur dhe aktet e procedimit penal nr. ***²⁹, nuk konstaton *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.

Dy denoncime nga shtetasi A. B. Z., drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit³⁰, i cili pretendon se subjektet e rivlerësimit mbrojnë abuzuesit e ligjit, pasi prej 8 vjetësh paraqet kallëzime ndaj punonjësve të ZVRPP-së Tiranë për abuzime, ndaj përmbaruesve për mosveprime, ndaj noterëve për falsifikim të listës së bashkëpronarëve, ndaj biznesmenëve për falsifikim bilanci dhe për shkelje nga më të ndryshmet. Denoncuesi ka bashkëlidhur disa dokumente për një subjekt tjetër rivlerësimi. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit nuk referon fakte apo vendim konkret.

Nga përmbajtja e këtij denoncimi nuk u evidentua të ishte i referuar emri i subjektit dhe as përshkrimi i ndonjë të dhëne që lidhej me të, referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, denoncimi nuk mund të trajtohet, për sa nuk ka të dhëna lidhur me subjektin dhe as akt të referuar të marrë prej saj.

Nëntë denoncime nga banorë të pallatit të shoqërisë “*” sh.p.k., rruga “***”, Durrës, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit**³¹. Denoncuesit ankohen për zvarritje të procesit/hetimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe disa subjekte të tjera, në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2019. Procedimi penal është regjistruar për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga nenet 248 dhe 199/1 të Kodit Penal, mbi bazë të kallëzimit të shtetasit B. Xh., sipas të cilit, si pasojë e ndërtimit tej lejes së miratuar nga Bashkia Durrës, nga 8+1 kat në 10+1 ka ndodhur edhe dëmtimi i godinës duke u mënjënuar. Denoncuesit kanë bashkëlidhur dokumentacionin në vijim: (i) topografin e pallatit; (ii) shkresën drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku denoncuesit pretendojnë se në shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk përmendet denoncimi i datës 7.2.2018, nuk përmendet emri i ndërtuesit, si dhe studimet e ekspertëve të thirrur nga prokuroria, aktekspertizat, nuk janë marrë parasysh; (iii) shkresën kthim përgjigjeje datë 5.10.2020, të Prokuroria së Rrethit Gjyqësor Durrës; (iv) shkresën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Durrës, që urdhëron banorët e pallatit, Lagjja ***, rruga “***”, Durrës, të largohen nga banesat brenda datës 8.10.2020, bazuar në aktekspertimin teknik-gjeodet, ku theksohet se objekti paraqet rrezikshmëri të lartë dhe duhet shembur. Gjithashtu, denoncuesi ka bashkëlidhur edhe shkresën e Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (i paqartë numri i protokollit), ku konfirmohet se ankesa është në fazën e shqyrtimit fillestar.

²⁸Denoncim nr. *** prot., datë 9.7.2018.

²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 1.4.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁰Denoncimet nr. *** prot., datë 25.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 5.7.2021.

³¹Denoncimet: nr. *** prot., datë 24.10.2020; nr. *** prot., datë 27.7.2020; nr. *** prot., datë 23.7.2020; nr. *** prot., datë 20.10.2020; nr. *** prot., datë 27.10.2020; nr. *** prot., datë 24.11.2020; nr. *** prot., datë 25.1.2021; nr. *** prot., datë 1.9.2021; dhe nr. *** prot., datë 22.7.2021.

Komisioni, referuar provave bashkëlidhur denoncimit, si dhe shkresës nr. *** prot., datë 4.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që konfirmon se procedimi penal nr. *** i vitit 2019 është ende në hetim, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe orientimet e dhëna nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit³² në lidhje me çështjet në shqyrtim, çmon se kontrolli i aftësisë profesionale nuk mund të kryhet për këtë çështje, sipas pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, pasi për rrjedhojë do të paragjykohej zgjidhja e një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit.

Tri denoncime nga shtetasi F. K., drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit³³, i cili pretendon se disa vendime të subjekteve të tjera, përfshirë edhe vendimet e subjektit të rivlerësimit, janë në sinkron me nepotizëm profesional në vendimmarrjet e tyre, me opinione ose argumente personale. Sipas pretendimeve të denoncuesit, subjekti i rivlerësimit, me vendimin për mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. *** prot., datë 23.1.2020, dhe kallëzimit nr. *** prot., datë 22.1.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi. Nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar, ankuesi nuk ka depozituar vendimin për mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. *** prot., datë 23.1.2020, dhe kallëzimit nr. *** prot., datë 22.1.2020. Denoncuesi ka bashkëlidhur vetëm shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.5.2020, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, sipas të cilës: *“Nga përmbajtja e ankesës nuk rezultojnë të dhëna për shkelje disiplinore nga ana e prokurores, për këtë arsye është vendosur arkivimi i ankesës suaj”*.

Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dosje të fashikujve përkatës për kallëzimin nr. *** prot., datë 23.1.2020, dhe kallëzimin nr. *** prot., datë 22.1.2020, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2022, informon se subjekti i rivlerësimit ka pasur në hetim çështjen penale nr. *** të vitit 2020. Bashkëlidhur shkresës, prokuroria ka vendosur në dispozicion kopje të fashikullit.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se në datën 23.1.2020 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës është regjistruar kallëzimi penal nr. *** prot., mbi bazën e kallëzimit të kryer nga shtetasi F. K. ndaj shtetasve A. M. dhe B. Q. (gjyqtarë pranë Gjykatës së ***), për veprën penale “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal. Kallëzimi penal mban datën 7.1.2020. Në datën 5.2.2020 subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur mosfillimin si procedim penal të kallëzimit nr. *** prot., datë 23.1.2020.

Në datën 26.2.2020 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës është paraqitur kërkesa penale me objekt kundërshtimin e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. ***, datë 23.1.2020, nga prokurorja Alma Bramo”, me kërkues K. T. K., përfaqësuar nga shtetasi F. K.. Në datën 22.6.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesës penale nr. *** si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në datën 30.6.2020 kërkuesja K. T. K., përfaqësuar nga shtetasi F. K., ka paraqitur pranë Gjykatës së Apelit Durrës kërkesën ankimore kundër vendimit të rrëzimit të kërkesës nr. ***.

Për sa më sipër, Komisioni, pasi administroi aktet e fashikullit penal të mosfilluar me nr. ***³⁴, nuk konstatoi shkelje nga subjekti i rivlerësimit. Ndërsa, në lidhje me kallëzimin nr. *** prot.,

³²Vendim (JR) nr. 33, datë 3.11.2021.

³³Denoncimet: nr. *** prot., datë 8.9.2020; nr. *** prot., datë 30.7.2020; dhe nr. *** prot., datë 18.5.2020.

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 4.4.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

datë 22.1.2020, Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2022, konfirmoi se prokuror i kësaj çështjeje ka qenë një subjekt tjetër dhe jo subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, gjithashtu, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit edhe për artikullin e publikuar në media³⁵, sipas të cilit: “*Prokurorja kërkoi mbylljen e çështjes *** pa thirrur dëshmitarët në gjykatë. U kërkua mbyllja e hetimit pa dëshmitë përkatëse*”, dhe vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka kompetencë të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, targa këto në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Qëndrimi i Komisionit mbi denoncimet

Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme, sipas ligjit nr. 84/2016, si dhe shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e prokurores.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Alma Bramo:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, në bazë të nenit 51, germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Alma Bramo, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

³⁵Denoncim në linkun https://alpennews.al/portret-kush-është-alma-bramo-prokurorja-që-tentoi-të-mbyllte-superskandalin-e-***-dhe-raportet-e-saj-pd/

3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 2.6.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku